



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:191080
Datë: 02.09.2024
Numri i dokumentit: 06112874

CAP.nr.325/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Hysni Bardheci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen përmbaremore të kreditores Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a., me seli në Prishtinë, Rr. “Nënë Tereza”, nr.36, kundër debitorit T.H., nga fshati K., Komuna e Glllogocit, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, PPP.nr.109/2019 të datës 19.10.2022, me datë 02.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit T.H., nga fshati K., Komuna e Glllogocit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore Prishtinë-Dega në Glllogoc, PPP.nr.109/2019 i datës 19.10.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.109/2019 të datës 19.10.2022, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit T.H.H. nga fshati K., Komuna e Glllogocit, kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat Rrezarta Metaj P.nr.2647/18 të datës 19.12.2018, me të cilin është lejuar propozimi për përmbaremore i kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit, lidhur me borxhin në shumën prej 2,235.94€. Në pikën II, urdhri i përmbaruesit privat Rrezarta Metaj P.nr.2647/18 i datës 19.12.2018, mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, duke mos cekur shkaqet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të pranoj si të bazuar ankesën e debitorit, të anuloj aktvendimin e atakuar dhe të shfuqizoj urdhrin për përmbaremore duke e detyruar kreditorin në pagesën e shpenzimeve për taksën e ankesës dhe kundërshtimit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datë 19.12.2018, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste lidhur me borxhin e krijuar për konsumin e energjisë elektrike në vlerë prej 2,235.94 euro, për periudhën kohore nga data 05.08.2011 e deri me datën 20.03.2013. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin me urdhrin P.nr.2647/18 të datës 19.12.2018, ndaj të cilit urdhër debitori ka ushtruar prapësim me datë 04.01.2019, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 21.03.2019. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nga kontrata për pagesën e borxhit e datës 30.08.2017, me nr.60090 si dhe deklaratës mbi dakordimin e borxhit e lidhur ndërmjet KEK-ut dhe debitorit, vërtetoi se të njëjtit kanë lidhur kontratë për faljen e borxhit me kusht që debitori të paguajë borxhin në shumë prej 917.47€, kurse shuma prej 2,439.94 € të falet, por me kusht se debitori mos të bëjë tri vonesa për pagesën e këstit, e në rastin konkret nga Transaksioni i Konsumatorit është vërtetuar se i njëjti ka paguar 4 këste (nga 51.00€), por nuk ka paguar tri këstet radhazi dhe për këtë arsye dhe duke zbatuar kontratën, kreditori ka vendosur që ta kthej borxhin e falur në vlerë prej 2,235.94€, pasi që debitori nuk ka paguar tri këste radhazi sipas kontratës. Ndërsa nga kontrata e njëjtë shihet se palët kanë bërë ri programim të borxhit të regjistruar me faturën DPR-9005733 në emër të debitorit ashtu siç shihet edhe në faturën e datës 18.12.2018 e cila i plotëson kushtet ligjore për tu trajtuar dokument i besueshëm. Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 21, 29, 37, 38, 40, 69, 71 dhe 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit se urdhri për përmbartim nuk është i mbështetur në dispozita ligjore. Kjo pasi që në bazë të nenit 29 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore është paraparë së *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e*

shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave". Ndërsa sipas paragrafit 3 të këtij neni është paraparë së "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar*". Në rastin konkret përmbartimi është caktuar në bazë të Ekstraktit nga librat afarist DPR-90057333, i cili bazuar në dispozitat e lartcekura është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbartim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Nga provat e të cilat gjinden në shkresat e lëndës, rezulton se kreditori dhe debitori, me datë 30.08.2017 kanë lidhur kontratën për pagesën e borxhit, të cilës i është bashkangjitur edhe deklarata mbi dakordimin e borxhit nr.60090 me çka debitori e ka pranuar borxhin total prej 2,439.94 euro, dhe ka arritur marrëveshje me kreditorin që të bëjë pagesën e borxhit në shumë prej 917.47 euro, në 18 këste sipas programit të pagesës së borxhit, me qëllim që të përfitojë faljen e borxhit të grumbulluar deri më datë 31.12.2008 në shumë prej 1,522.47 euro, konform Ligjit Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike. Mirëpo, meqenëse debitori nuk e ka bërë pagesën e kësteve sipas marrëveshjes së lidhur, kreditori duke vepruar konform nenit 3 të kontratës ku parashihet se "*në rast se përfituesi shkakton 3 pagesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas Programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e pa paguar e borxhit, nëse ka, fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet*", i ka rikthyer debitorit të gjithë borxhin e vjetër, duke i zbritur vlerën e pagesave të bëra, ashtu që tani kreditori ka kërkuar borxhin në shumë prej 2,235.94 euro.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga ekstrakti i verifikuar nga librat afariste DPR-90057333, rezulton se debitori ka paguar 4 këste nga 18 sa ishin të parapara me kontratë për pagesën e borxhit, ku debitori është obliguar që këtë borxh t'ia paguaj kreditorit dhe atë këstin e fundit me datën 28.07.2020, ndërsa duke pasur parasysh faktin se debitori nuk ka paguar këstet siç ishte përcaktuar me deklaratën për dakordimin e borxhit, rezulton se i njëjti ka shkaktuar tre (3) vonesa të njëpasnjëshme. Andaj, duke u bazuar në nenin 3 të kontratës për pagesën e borxhit, kreditori me të drejtë ka bërë rikthimin e borxhit duke i zbritur vlerën e pagesave të bëra nga debitori. Për me tepër, edhe në bazë të nenit 6 paragrafi 3 të Ligjit për Faljen e Borxheve Publike, përcaktohet se: "*Pavarësisht dispozitave të nenit 4 të këtij ligji, nëse personat të cilët përfitojnë nga ky ligj përmes arritjes së marrëveshjes për pagesën me këste të obligimeve për periudhën 1 janar 2009 deri 31 dhjetor 2014, dështojnë në respektimin e kushteve të marrëveshjes, atëherë, Institucioni Shtetëror apo Ndërmarrja Publike ka përgjegjësi që të njëjtin ta vendosë në listën e borxheve, duke e bërë obligues për të gjitha borxhet e mbetura sipas kërkesave ligjore që kanë qenë të zbatueshme para lidhjes së marrëveshjes*".

Lidhur me pretendimin e debitorit të paraqitur në ankesë sa i përket parashkrimit të kërkesës, Gjykata e Apelit vlerëson së debitori këtë pretendim ka pasur mundësi ta paraqet përmes prapësimit, pasi që sipas nenit 180 par.3 të LPK-së, prapësimi i parashkrimit që nuk është paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë. Mirëpo, edhe po që se debitori do ta paraqiste prapësimin e parashkrimit përmes kundërshtimit të urdhrin përmbartimor, në këtë rast gjykata vlerëson së nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës. Kjo

pasi që sipas dispozitës së nenit 368 paragrafi 1 të LMD-së shprehimisht përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”*, ndërsa me paragrafin 2 përcaktohet se: *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Në kuptim të kësaj dispozite Gjykata e Apelit, gjeti së kreditori dhe debitori, me datën 30.08.2017 kanë lidhur kontratën për pagesën e borxhit, të cilës i është bashkangjitur edhe deklarata mbi dakordimin e borxhit, e cila ka ndikuar në ndërprerjen e parashkrimit, pasi që me këtë kontratë debitori e ka pranuar borxhin total prej 2,439.94 euro. Në bazë të nenit 373 par.2 të LMD-së, është paraparë së *“Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimi (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi)”*. Në rastin konkret në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afariste (transaksioni i konsumatorit) rezulton së debitori këstin e fundit (kësti 4) në vlerë prej 51.00 euro e ka bërë me datë 19.05.2018, ndërsa kreditori prozimin për përmbarim e ka paraqitur me datë 19.12.2018, çka rezulton së nuk ka kaluar afati prej një viti në mënyrë që kërkesa e kreditorit të përfshihet në parashkrim.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.325/2023, datë 02.09.2024

Gjyqtari
Hysni Bardheci